



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE
VENDIM

Nr. 14, Datë 10/05/2016

PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI ME 10.08.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDOHEN AKTE FITIMI PRONËSIE DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE.

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 10.05.2016 në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të VKM 608, datë 05.09.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre" si dhe të vendimeve të dërguara nga Bashkia Sarandë.

VENDOSI :

1. Të miratojë Vendimin Nr. 01, datë 04.02.2016 "Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj" për shtetasin Z. Kiço Mërtiri, për objektin : "**Banesë Vetiake 2 (dy) katëshe**", e ndodhur në Lagjen "Nr. 2". Rruga "**Aleks Verli**" të qytetit të Sarandës) me sipërfaqe ndërtimi 130 m² (kati i parë) dhe 130 m² (kati përdhe) dhe sipërfaqe truall funksional 200 m², zona kadastrale 8641, nr. pasurie 11/362 që kufizohet nga Veriu me objekt 2 katësh , Jugu me pasurinë nr. 11/361, nga Lindja me pasurinë nr. 11/363 dhe nga Perëndimi me rrugën "Aleks Verli".
2. Të miratojë Vendimin Nr. 02, datë 01.04.2016 "Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj" për shtetasin Z. Nestur Kolagji, për objektin : "**Banesë Vetiake 1 (një) katëshe me podrum**", e ndodhur në Lagjen "Nr. 1" të qytetit të Sarandës) me sipërfaqe ndërtimi 109.5 m² (kati përdhe)+23 m² (podrum) dhe sipërfaqe truall funksional 170 m², zona kadastrale 8641, nr. pasurie 12/373 që kufizohet nga Veriu me pasurinë 12/370 , Jugu me rrugë, nga Lindja me pasurinë nr. 12/25 dhe nga Perëndimi me pasurinë 12/27.

KRYETARI I KËSHILLIT QARKUT

Sadrit DANA



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr: _____ prot. dt. ___/___/2016

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site : www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600